



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

**BURSA PËR STUDIME UNIVERSITARE DHE PASUNIVERSITARE NË  
REPUBLIKËN ARABE TË EGJIPTIT**

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh në fushën e arsimit me Republikën Arabe të Egjiptit, Ministria e Arsimit të Lartë të Egjiptit ofron bursa për studime universitare dhe pasuniversitare për kandidatë shqiptarë, të cilët dëshirojnë të ndjekin studimet në universitetet publike egjiptiane, për vitin akademik 2018-2019.

Kandidatët e interesuar për të filluar studimet universitare/pasuniversitare me shpenzimet e tyre (pa bursë), duhet të aplikojnë nëpërmjet portalit <https://Wafeden.gov.eg>; ose faqen në web [www.mohe-casm.edu.eg](http://www.mohe-casm.edu.eg) deri në **31.08.2018**, që është edhe afati i fundit për aplikim . Gjithashtu, studentët që do të ndjekin studimet universitare/pasuniversitare me bursë duhet të aplikojnë direkt në portalin [www.mohe-casm.edu.eg](http://www.mohe-casm.edu.eg) ,

Për bursat e studimit prioritet do t'u jepet kandidatëve që kanë përfunduar shkollën e mesme në vitin akademik 2018-2019. Kusht i rëndësishëm është që kandidatët e interesuar që do të aplikojnë për këto bursa studimi duhet të njohin gjuhën arabe (bashkëlidhur udhëzimi përkatës në gjuhën arabe).

Nënvizojmë gjithashtu se bursat e akorduara për vitin akademik 2018-2019 nuk mund të transferohen në vitin pasardhës.

Emrat e kandidatëve të interesuar për studime universitare/ pasuniversitare me/pa bursë studimi do të përcillen në Departamentin Qendror për Çështjet e Studentëve të Huaj në Ministrinë e Arsimit të Lartë të Egjiptit brenda datës **31 Gusht 2018** që është afati i fundit për aplikim.

**DREJTORIA E INTEGRIMIT KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE**

**ASISTENCËS**